Project: Date ...../...../.........

# Protokoll Nr 3.

Ky protokoll mbahet sot më datë 30.03.2026, ora 10^00
në sallën e mbledhjeve të KB Divjakë, kati i dytë, në
Godinën e Bashkisë Divjakë, për zhvillimin e mbledhjes së
radhës së KB, për muajin Mars 2026
Marrin pjesë në mbledhje Këshilltarët:

Liri Bizi, Ardian Dodo, Zotjona Budani,
Njazi Bollo, Julian Vrapi,
Elona Stambolliu, Elmerinda Sina,
Xhorxhi Kruti, Indrit Zejjona
Afete Mebelli, Elda Sinani, Jurgen Shuli
Roza Broshka, Astrit Dervishi,
Ardjan Shurdhaqi, Mishel Verdho,
Sahit Ibrahimaj, Seit Leajo,
Lili Bizi, Adelajda Guli.

Meqënëse u plotësua kuorumi për zhvillimin e
mbledhjes Kryetarja znj. Liri Bizi e deklaron
mbledhjen të hapur dhe kalohet tek:

Rendi i ditës.

1. Miratim i Rendit të ditës.
2. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së dt. 27.2.2026.
3. Informacion mbi zbatimin e VKB për muajin Shkurt 2026.
4. Projekt vendim Nr. 25 dt. 11.3.2026 "Mbi miratimin e përfundimit të procedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK, pronë Drejtorisë Vendore Lushnje, për lidhjen e kontratave para noterit.
5. Projekt vendim nr 26 dt. 13.03.2026 "Për miratimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të këshilltarit z. Bido Dermyshi
6. Projekt vendim Nr. 27 dt. 13.03.2026 "Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Shkurt 2026.
7. Projekt vendim Nr. 28 dt. 13.03.2026 "Për miratimin e tabelave përgatitore të shpenzimeve për PBA 2027-2029.
8. Projekt vendim Nr. 29 dt. 13.03.2026 "Për miratimin e listës së detyrimeve të prapambetura të cilat do të likuidohen nga fondi 30% i të ardhurave të trashëguara.
9. Projekt vendim Nr. 30 dt. 17.03.2026 "Për një ndryshim

të Vendimit Nr. 75 dt. 26.11.2025 "Për miratimin e projektit "Rishikimi i projektit të ujitjes me presion për skemën e ujitjes Divjakë".

10. Projekt vendimi Nr. 31 dt. 17.03.2026 "Për një ndryshim në VKB Nr. 13 dt. 24.2.2025 "Për mbështetjen financiare të nxënësve me arritje të shkëlqyera në shkollat publike të Bashkisë Divjakë.

11. Projekt vendim Nr. 32 dt. 18.3.2026 "Për një ndryshim në VKB nr 89 dt. 29.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve të B. Divjakë, Institucioneve në varësi të Njësive Administrative dhe të funksioneve të deleguara për vitin 2026.

12. Relacion mbi paraqitjen e Raportit të performances së Bashkisë Divjakë.

13. Informacion për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve për vitin 2025

14. Relacion mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën Janar - Dhjetor 2025.

15. Informacion nga Agjensia e Shërbimeve Komunale për nxjerrje nga përdorimi të aktiveve për vitin 2025.

1. Pika e parë e rendit të ditës.
- Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja znj. Rin Biti i drejtohet këshilltarëve: A kemi pyetje, shtesa, plotësime mbi rendin e ditës?

Merr fjalën znj Fatjona Budom, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë dhe financave kei propozon që të shtohen në rendin e ditës dhe këta projektvendime: 1. Projektvendimi Nr. 33 dt. 24.3.2026 "Për një ndryshim në VKB nr 85 date 29.12.2025.

2. Projektvendimi Nr. 34 date 24.3.2026 "Për miratimin e një rishpërndarje fondesh në buxhetin e v. 2026 nga programi 01066 "Strehimi social" tek programi 010430 "Kujdesi social për familjet dhe fëmijët.

3. Projekt vendimi Nr. 35 dt. 30.03.2026 "Për një ndryshim të VKB nr. 12 dt. 27.02.2026 "Për miratimin e bashkëfinancimit për projektin e përmirësimit të banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara për vitin 2026.

Project: Date ...... /...... / ..........

Propozoi gjithashtu që të renditen pas Nr. 11 Projekt vendimit nr 32 dt. 18.3.2026.
Gjetje të tjera s'ka, shtesa të tjera s'ka, diskutime për rendin e ditës s'ka.
Hidhet në votim pika e parë e rendit të ditës dhe votohet me 20 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

2. Pika e dytë e rendit të ditës
Miratimi i procesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më datë 27.02.2026.
Gjetje për procesverbalin nga këshilltorët, s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e dytë e rendit të ditës dhe votohet me 20 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

3. Pika e tretë e rendit të ditës
- Informacion mbi zbatimin e vendimeve të KB për muajin Shkurt 2026.
Gjetje s'ka, diskutime për informacionin s'ka.
Kalohet tek raportet e shqyrtimit të Projekt vendimeve nga Komisionet përkatëse.
Kryetarja znj. Liri Bili i a jep fjalën për relatim znj. Koltjona Budoni, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë dhe financave, e cila shprehet: Komisioni i Ekonomisë dhe financave u mblodh më datë 25.3.26 dhe pasi shqyrtoi Projekt vendimet e paraqitura nga Bashkia vendosi që të kalojnë për miratim Projekt vendimet: Nr. 27, 28, 29, 31, 32, 33, 34, në mbledhjen e KB.
Projekt vendimet u votuan nga anëtarët e komisionit me 4 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
Kryetarja znj. Liri Bili i a jep fjalën për relatim znj. Ajete Mebelli për raportin e Komisionit të Bujqësisë për shqyrtimin e Projekt vendimit Nr. 30 datë 17.03.2026 e cila shprehet se Komisioni i bujqësisë në mbledhjen e dt. 20.3.2026 vendosi që ky Pr. vendim të kalojë për miratim në mbledhjen dhe u votua me 4 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim. Kalohet tek pika e katërt.

4. Pika e katërt e rendit të ditës

- Mbi miratimin e përfundimit të procedurës se privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK pronë Drejtorisë Vendore Lushnje, për lidhjen e kontratave para noterit.
Kryetarja znj. Lin Bili ia jep fjalën për relatim për pikën e katërt të rendit të ditës z. Andi Bullari.
z. Andi Bullari i propozon këshilltarëve që të miratojnë këtë projektvendim, por edhe me një shtesë, ku kërkesa e qytetarit ka ardhur në dt. 27.3.2026. Përkatësisht lista e emrave është: - Dylber Demir Rushitaj, banues në Germë Sektor me adresë rruga Pallatet Bullgare, ka aplikuar dhe ka paraqitur dokumentacionin përkatës për apartamentin e ndodhur në Pallatin Nr 60 në Cermë Sektor me zonë kadastrale 3578, dokumentacioni ndodhet në dosjen e privatizimit.
- Vangjel Spiro Siveri banues në Lushnje, ka aplikuar dhe ka paraqitur dokumentacionin për Apartamentin e ndodhur në Pallatin Nr 15 Grabjan me zon kadastrale nr 1827, dokumentacioni ndodhet në dosjen e privatizimit.
- Elton Xheka, banues në Grabjan, i cili ka paraqitur kërkesën me nr prot. 2350 dt. 27.3.2026 për regjistrimin e një apartamenti në Grabjan.
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e katërt e rendit të ditës dhe votohet me 20 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

5. Pika e pestë e rendit të ditës.
- Për miratimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të këshilltarit z. Bido Dermyshi.
Lexon raportin Kryetarja e Komisionit të Mandateve znj. Elona Stambolliu, ku shprehet se Komisioni i mandateve pasi mori në shqyrtim kërkesën për dorëheqje të këshilltarit z. Bido Dermyshi i propozojmë këshillit të pranojë këtë dorëheqje nga mandati i këshilltarit, përpara afatit, dhe ta miratojë atë.
Pyetje për pikën e pestë të rendit të ditës s'ka.
Diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e pestë e rendit të ditës dhe votohet me 20 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

Project: Date ...... /...... / ..........

6. Pika e gjashtë e rendit të ditës
- Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Shkurt 2026
Drejtuesja znj. Lini Bili ia jep fjalën për relatim z. Xhulio Muço, përgjegjësit të Sektorit të ndihmës ekonomike, ku i propozon këshilltarëve që të miratojnë familjet në nevojë të dala nga sistemi i pikëzimit me pikët e mjaftueshme dhe që kanë aplikuar, pasi u është bërë dhe verifikimi në familje, të trajtohen me ndihmë ekonomike me fond deri 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Shkurt, 13 familje me një fond prej 63,223 lekë. Lista e familjeve është:
Elisabeta Zaj 10692 lekë, Afrodita Lupi 5940 lekë
Esmeralda Gjoto 7920 lekë, Vitrina Sula 5940 lekë,
Ymer Alboyani 1525 lekë, Alketa Meta 5227 lekë
Mimoza Krasniqi 2178 lekë, Bashkim Gjini 1525 lekë,
Zeqir Zeqiri 3703 lekë, Neim Doxe 5227 lekë
Suzana Muça 5940 lekë, Bardhul Torko 3703 lekë,
Klodiana Ndoni 3703 lekë
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e gjashtë e rendit të ditës dhe votohet me 20 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

7. Pika e shtatë e rendit të ditës.
- Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2027-2029 për Bashkinë Divjakë.
Relaton Drejtori i Financës dhe Buxhetit z. Xhelo-din Brahkala, dhe i propozon këshilltarëve që të miratojnë tavanet përgatitore të shpenzimeve për PBA Vendor 2027-2029 për Bashkinë Divjakë sipas:

| PBA1 "Tavanet përgatitor" | Parashik. v.2027 | Parash. v.2028 | Parash. v.2029 |
|---|---|---|---|
| Totali për Tr. kushtëz. | 881,798,745 | 884,250,806 | 885,182,699 |

si dhe të miratojnë burimet buxhetore sipas parashikimit të të ardhurave.

| PBA2 - Të ardhurat | v.2027 | v.2028 | v.2029 |
|---|---|---|---|
| - Nga Transf. e kushtëz. | 881798745 | 884,250,806 | 885182699. |

Për përgatitjen e tavaneve përgatitore të shpenzimeve

për PBA 2027-2029, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit është mbështetur në Buxhetin e v. 2026, në VKB nr 85 dt. 29.12.2025 " Mbi miratimin e kalendarit orientues për menaxhimin e shpenzimeve vendore për PBA 2027-2029, në VKB nr 13 dt. 27.02.2026 " Për miratimin e raportit të vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave në Bashkinë Divjakë për vitet 2027-2029.

Burimet e financimit për Bashkinë Divjakë në bazë të UMF nr. 07. dt. 27.2.2026 " Për përgatitjen e PBA 2027.-2029 janë:

| Parashikimi | | | në leke |
|---|---|---|---|
| Burimet buxhetore | v. 2027 | 2028 | 2029 |
| 1. Trashëgimia nga v. kalu. | 73677739 | 65123162 | 50.000000. |
| 2. Të ardh. nga bur. veta | 230468000 | 230979000 | 231681000. |
| 3. Transf. pakusht. përgj. | 323368000 | 337402000 | 350825000. |
| 4. Niveli i Pagave TP | 57741000 | 57741000 | 57741000. |
| 5. Transf. pakushtëz sekt. | 193005644 | 193005644 | 194935699. |
| 6. Projekti Joinable | 3538362 | 0 | 0 |
| 7. Transf. e kushtëzuar | 288600000 | 288600000 | 288600000. |
| Totali | 1.170398745 | 1172850806 | 1173782,699. |

Drejtori i Financës dhe Buxhetit i analizon një për një si të ardhurat e planifikuara si dhe shpenzimet e planifikuara sipas burimit të të ardhurave, të cilat janë paraqitur nëpërmjet pasqyrave bashkëngjitur Projektvendimit dhe relacionit.

Kryetarja znj. Lin Bizi: A kemi pyetje? A kemi diskutime?/ Pyetje s'ka, diskutime s'ka.

Hidhet në votim pika e shtatë e rendit të ditës dhe votohet me 19 vota pro, 1 votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

Këshilltari z. Sokit Xhelilaj shprehet se votoj kundër se në këtë Program Afatmesëm Buxhetor nuk ka asnjë projekt investimi bashkëngjitur.

8. Pika e tetë e rendit të ditës.

- Për miratimin e listës si detyrimeve të prapambetura të cilat do të likujdohen nga fondi 30% i të ardhurave të trashëguara.

Kryetarja znj. Lin Bizi i jep fjalën për relatim, Drejtorit të Financës dhe Buxhetit z. Xhelodin Brahkola, kuli propozon këshilltarëve që të miratojnë listën e

Project: Date ...... / ...... / ..........

detyrimeve të prapambetura të cilat do të likuidohen nga fondi 30% i të ardhurave të trashëguara. Të ardhurat e trashëguara nga viti 2025 në v. 2026 të cilat u miratuan me VKB nr 15 dt. 27.02.2026 në vlerën 47.220.127,00 lekë. Fondet të cilat do të përdoren për likuidimin e detyrimeve të prapambetura janë 30% e vl. totale të të ardh. në vlerën 14 288 539 lekë ku kjo vlerë është e pasqyruar sipas listës së detyrimeve bashkëngjitur projekt vendimit.

Kryetarja zj. Din Biti i drejtohet këshilltarëve: A keni pyetje apo diskutime?

z. Ardian Vodo: Përse nuk janë likuiduar në kohën e duhur, se një pjesë e këtyre detyrimeve janë planifikuar në buxhet dhe me sa shikoj këto fonde janë në buxhet për çdo zë shpenzimi.

Sqaron Drejtori i Financës dhe Buxhetit mbi detyrimet e prapambetura duke përmendur investimet e vitit 2025 por që likuidohen në vitin 2026. Faturat e shpenzimeve energji, një të muajve Nëntor-Dhjetor 2025 likuidohen në v. 2026 etj, si dhe ka fatura të cilat operatorët i sjellin me vonesë.

z. Ardjan Shurdhagi: Cilat janë arsyet që janë pa likuiduar. Shikoj blerje çakulli që nuk i keni likuiduar brenda vitit, ku planifikimi i investimit brenda vitit planifikohet së bashku me fondin. A ka ndonjë arsye tjetër përveç dokumentave të paregjistruara nga operatorët me vonesë? A është bërë ndonjë investim i paplanifikuar, dhe për këtë mbetën faturat pa u likuiduar? Përveç rasteve të veçanta, kur operatorët i bien faturat me vonesë.

z. Astrit Dervishi: Vendimet e Gjykatave ç'farë natyre kanë? Përgjigjet Drejtori i Financës dhe Buxhetit. Për shikimin dy fatura me të njëjtën datë, a mund të më japësh sqarime? Jep sqarimet e nevojshme Drejtori i Financës. Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka. Hidhet në votim pika e tetë e rendit të ditës dhe votohet me 20 vota pro, asnjë votë abstenim dhe asnjë votë kundër.

9. Pika e nëntë e rendit të ditës.

- Për një ndryshim të VKB nr 75 dt. 26.11.2025

- Për miratimin e projektit rishikim i projektit të ujitjes me presion për skemën e ujitjes Divjakë.
Relatoi juristi z. Andi Bulloni, ku i propozoi këshilltarëve që të miratojnë një ndryshim të VKB nr 75 dt. 26.11.2025.
Sqaroi këshilltarët mbi shkresën e ardhur nga Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit rural, ku Banka Botërore e plotëson kushtin teknik për sigurimin e presionit të nevojshëm për ujitjen në të gjithë sipërfaqen e projektuar për ujitje me presion, ndërsa në lidhje me kushtin e minimizimit të ndotjes së ujit, ky shqetësim i është adresuar Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
Fjalën: z. Astrit Dervishi; Si do zgjidhet problemi i Çermë Sektorit. Atje është kolektori kryesor dhe mund të bëhet lidhje, gjithashtu edhe filtrimi i ujit.
z. Sokit Ibrahimaj: Mendoj se edhe ky investim duhet të ketë bashkëngjitur projektin. Për çdo investim të jetë projekti i bashkëngjitur. Fjalën të tjerë s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e nëntë e rendit të ditës dhe votohet me 20 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

10. Pika e dhjetë e rendit të ditës.
- Për një ndryshim të VKB nr 13 dt. 24.2.2025 "Për mbështetjen financiare të nxënësve me arritje të shkëlqyera në shkollat publike të Bashkisë Divjakë.
Kryetarja znj. Lin Biti ia jep fjalën për relatim z. Xhelodin Brahkola, drejtor i Financës dhe Buxh.
Drejtori i Fin. dhe Buxh. i propozoi këshilltarëve që të miratojnë ndryshimin e pikës 5 të VKB nr 13 datë 24.2.2025, e cila është mbështetje financiare 10000 lekë, të shkojë në 15000 lekë, për nxënësit me arritje të shkëlqyera, ekselentë.
Relatori dhe Kryetari i Bashkisë.
Diskutoi këshilltarja znj. Ajete Hebelli.
Fjalën znj. Lin Biti: Nga cila klasë fillon shpërblimi i nxënësve?
Përgjigjet z. Xh. Brahkola: Sivjet nga klasa e 9.të viteve e tjera nga kl. e VI.
z. Ardjan Shumdhuqi: Mendoj se do të jetë shumë mirë

që ky shpërblim të fillojë që nga klasa e VI gjatë deri
në klasën e dymbëdhjetë.
z. Sahit Ibrahimaj: Mendoj që nxënësit që marrin pjesë
në olimpiada dhe fitojnë, të pajisen me certifikata, si në
lëndë të ndryshme, në sporte, dhe të marrin shpërblim.
Sqaron Kryetari i Bashkisë z. Josif Gorrea.
z. Astrit Dervishi: Mendoj se duhet të miratojmë disa
kritere, për medaljet e marra në këto olimpiada dhe të
marrin shpërblim, në sporte, në koncerte artistike, etj.
znj. Roza Troshku: Kur do të filloj shpërblimi i nxënësve?
Përgjigjet Kryetarja e Këshillit znj. Klin Biti.
Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e dhjetë e rendit të ditës dhe
votohet me 20 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë
votë abstenim.
11. Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës.
- Për një ndryshim në VKB nr 89 dt. 29.12.2025 "Për
miratimin e nr të punonjësve të B. Divjakë, institu-
cioneve në varësi, të Nj. Adm. dhe funksioneve të delegu-
ara për vitin 2026. Ftohet znj. Zotjana Badoni,
Relatore Përgjegjëse pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore
znj. Atalanta Simaku, ku i propozon këshilltarëve të
miratojnë ndryshimin e numrit të përgjithshëm të punonj.
të Bashkisë në Administratën Qendrore dhe Nj. Adm., si
rrjedhojë e ristrukturimit të nëpunësve të gjendjes civile
duke e ulur nr total nga 488 punonjës në 486 punonjës.
Sqaron dhe Kryetari i Bashkisë për këtë projekt vendim.
z. Astrit Dervishi: Këto janë fonde të deleguara.
z. Njazi Bolla: Punonjësja e Nj. Adm. Tërbuf do të vij
në Divjakë? Përgjigjet Kryetari i Bashkisë: Po.
Sipas shkresës së ardhur nga Ministria.
Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës
dhe votohet me 19 votë pro, asnjë votë kundër dhe
asnjë votë abstenim.
12. Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës shtesë e rendit.
- Për një ndryshim në VKB nr 85 dt. 29.12.2025.
Relator Drejtori i Financës dhe Buxhetit dhe i propozon
këshilltarëve që të miratojnë një shtesë funksioni në

Project: Date ...... /...... / ..........

pikën 1 të këtij vendimi dmth. përmes së) që Drejtoria Rajonale shpk të merret me Organizimin dhe administrimin e eventeve kulturore, ngjarjeve artistike.
Në këtë pikë sqaroi këshilltarët dhe Kryetari i Bashkisë.
Z. Astrit Dervishi: A janë caktuar fondet?
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë. Z. Astrit Dervishi: A i ka kapacitetet e nevojshme për këto funksione?
Përgjigjet Z. Josif Gorrea Kryetari i Bashkisë.
Z. Salit Tërshnjaj: Përse nuk kalohet direkt me Vendim, por e kalojmë me ndryshim VKB. ose të anullohet VKB i mëparshëm dhe të marrim Vendim direkt të ri, me të gjitha funksionet.
Përgjigjet Drejtori i Financës: Mund të bëjmë për një shtesë në VKB.
Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika shtesë e dymbëdhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 11 vota pro asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
13. Pika shtesë e trembëdhjetë e rendit të ditës.
- Për miratimin e një rishpërndarje fondesh në Buxhetin e vitit 2026 nga programi 010661 "Strehimi social" tek programi 010430 "Kujdesi social për familjet dhe fëmijët".
Relatori Drejtori i Financës dhe Buxhetit dhe i propozoi këshilltarëve që të miratojnë rishpërndarjen e fondeve në buxhetin e Bashkisë Divjakë për investimet sipas kapitujve programeve dhe llogarive, miratuar sipas VKB nr 87 dt. 29.12.2025. Kjo rishpërndarje do të kryhet bazuar në projektin që ka aplikuar B. Divjakë: Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara Divjakë si: Buxheti ishte: Fond për projekte të strehimit social nga të ardhurat v. 2026 i PBA 2026-2028 = 1000 000 lekë dhe bëhet: Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara Divjakë në PBA 2026-2028 nga të ardhurat 05-2026 me vlerë 1000000 lekë.
Z. Ardjan Shundi(?): Kjo ishte për projektin e përmirësimit të banesave dhe po kalon tek Strehimi social?

Project: Date ...... /...... / ......65.

Përgjegjësi Drejtori i Financës dhe Buxhetit z. Xh. Brahkolo.
Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e trembëdhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 19 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

14. Pika e katërmbëdhjetë e rendit të ditës (projektvendim shtesë)
- Për një ndryshim të VKB nr 12 datë 27.2.2026 "Për miratimin e bashkëfinancimit për projektin e përmirësimit të banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara për vitin 2026.

Kryetarja znj. Lin Biti ia jep fjalën për relatim Përgjegjësit të Sektorit të ndihmës ekonomike z. Ledio Oliuçi, ku i propozon këshilltorëve që të miratojnë ndryshimin e VKB nr 12 datë 27.2.2026, ku % e bashkëfinancimit bëhet nga 20% në 30%, një ndryshim i cili çon dhe në ndryshimin e vlerës së bashkëfinancimit. Tani në VKB nr 12 dt. 27.02.2026 ishte:
Të miratojë listën e familjeve sipas kategorive që plotësojnë kriteret sipas ligjit në fuqi për projektin Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara për Bashkinë Divjakë për vitin 2026, kuota e bashkëfinancimit e shprehur në 20% me vlerë 2.353.855 lekë, fondi për mbikëqyrjen e projektit me vlerë 135636 lekë dhe fondi i kolaudimit me vlerë 16284 lekë. Të bëhen:
- Të miratojë listën e familjeve që plotësojnë kriteret.
- Të miratojë kuotën e bashkëfinancimit nga Bashkia Divjakë në masën 30% me vlerë 3.530.783 lekë për projektin.
- Të miratojë fondin për mbikëqyrjen e punimeve në këtë projekt në vlerën 135 636 lekë
- Të miratojnë fondin për kolaudimin e punimeve të projektit në vlerën 16284 lekë.

Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e katërmbëdhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 19 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

15. Pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës
- Për paraqitjen e Raportit të performancës së B. Divjakë

Project: Date ...... /...... / ..........

Raportin para këshilltarëve e lexon koordinatorja
pranë zyrës së Integrimit Europian znj. Esmeralda
Hanzaj. Ajo shprehet se ky dokument është në faqen
e webit të Bashkisë dhe përbëhet prej 146 faqe.
Pyetje s'ka, diskutime s'ka. Kalohet në:

16. Pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit të ditës.
- Informacion për nxjerrje nga përdorimi të aktiveve
për vitin 2025 Bashkia Divjakë.
Relaton Përgjegjësi i Financës pranë Drejtorisë së
Financës dhe Buxhetit z. Astrit Boska. Sqaron
këshilltarët mbi procedurën e ndjekur për aktivet
e konsumuara dhe që nuk përdoren më në procesin
e punës. Pyetje s'ka, diskutime s'ka.

17. Pika e shtatëmbëdhjetë e rendit të ditës.
- Relacion mbi monitorimin e zbatimit të Buxhetit
për periudhën Janar-Qershor 2025.
Relaton Drejtori i Financës dhe Buxhetit z. Xhelodin
Brahkola duke përmendur realizimin e të ardhurave,
shpenzimeve, investimeve për vitin 2025. Kemi
akoma investime të papërfunduara sidomos Ujësjellësi
Remas.
Pyetje: z. Astrit Dervishi: Sa është përqindja e
investimeve ndaj gjith buxhetit total?
Përgjigjet Drejtori i financës: Rreth 20-22% të buxhetit.

18. Pika e tetëmbëdhjetë e rendit të ditës.
- Informacion nga Agjencia e Shërbimeve Komunale
për nxjerrje nga përdorimi i aktiveve për vitin 2025.
Relaton Përgjegjësja e sektorit të financës pranë Agjencisë
znj. Migena Osmani, duke sqaruar këshilltarët mbi
procedurat mbi nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit.
Kalohet tek zëri të tjera:
z. Sahit Ibrahimaj: Diskuton mbi postrimin e kanaleve
në Terras, shtrimin e rrugëve të varrezave, projektet
në buxhet janë planifikuar por akoma punimet nuk
kanë filluar. Përgjigjet Kryetari i Bashkisë.
z. Mojsi Bolla: Problematik janë dhe rrugët e Cermë
Sektorit. z. Ardjan Vaolo: Po rrugët e lagjeve të
fshatrave Zharrëz etj. Përgjigjet Kryetari i Bashkisë.
Kemi 4 rrugë kryesore. z. Astrit Dervishi: Mef Zhe Shqiptar

SHQIPËRISË

Project: Date ...... / ...... / ..........

do të realizohen? 2. Njazi Bolle: Sa km rrugë bëhen? Përgj. Kryetari: 5km. 2. Jurgen Shuli ngre problematikën e mbushjes së fushës së sportit në Koravastë me mbetje të cilat po shtohen nga dita në ditë. Është kthyer në fushë mbetjesh.
Kryetarja znj. Liri Bite e deklaron mbledhjen e KB të mbyllur.
Procesverbali u mbajt nga sekretari i K.B. Gjyzeli.
Sekretari e KB.
Mimoza Gjomaj

Kryetare e KB.
Liri Bite

Roza Troshku

Elvira Simoni

Elverina Ging

Elona Stamballiu

Seit Vaso

Indrit Zgjomeni

Ndrezi Baullo Nefa

Adelajda Guli

Astrit Dervishi

Jurgen Shuli

Gjete Mesolli